



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.2301/2017

[Handwritten signature]

Më
Dana

11 - 11 - 2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari individual Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Lavdije Brahimë, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], komuna [REDACTED], i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1771-1/17 të dt.13.09.2017 për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtje të shqyrtimit gjyqësor, me dt.11.10.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1771-1/17 të dt.13.09.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] nga fshati [REDACTED], komuna [REDACTED], i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED], i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sepse me datë 24.08.2017, rreth orës 12:30, në pyllin-vendin e quajtur "Plenijat" Rajoni Ekonomiko- Pyjor "Nerodime-Jezerc", me të cilin Qeverisë Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari Komuna e Ferizajt, i pandehuri me qëllim për të vjedhur, ka prerë 1 copë trungje-dru të llojit ahu, me sharre motorike, me dimensione të gjata boniteti III, me diametër 60 cm, me vëllim të përgjithshëm prej 3.00 metër kub, me ç 'rast të dëmtuarës Autoriteti Pyjor Ferizaj, i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 405,00 €,-

-Me të cilën kreu veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7, 17,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPPK-së.

G J Y K O N

Të akuzuarin [REDAKTUAR] me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqindë) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundë të paguaj gjobën, sipas nenit 46, par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 Euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 405,00 Euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjithashtu obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, këto në fat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1771-1/17 të dt.13.09.2017, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], komuna [REDAKTUAR], për veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.2 dhe 3 të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës gjegjësisht, fletëparaqitjen e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj nr.155/17 e dt.29.08.2017 si dhe procesverbalin me nr.546/17 e dt.29.08.2017, konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 405,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.2301/2017 dt.11.10.2017

Zyrtare Ligjore
Lavdije Brahim

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.